REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 9-184 8280
Nr. i faq.
Data 20/10/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

**Zyra e Kryetarit**
**Datë: 20.10.2026**

Duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Zyra e Kryetarit bënë këtë:

# NJOFTIM PUBLIK

Komuna e Junikut ju fton të merrni pjesë në takimin konsultativ me qytetarët dhe palët e interesuara për Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, me qëllim të prezantimit dhe shqyrtimit të përbashkët të dispozitave të saj, si dhe të mbledhjes së komenteve, propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e saj para miratimit përfundimtar.

Në mënyrë të veçantë, ftohen të marrin pjesë:
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
- Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Të rinjtë dhe organizatat rinore e të shoqërisë civile;
- Përfaqësuesit e bashkësive lokale;
- Si dhe të gjithë qytetarët e interesuar të Komunës së Junikut.

Gjatë takimit do të prezantohen dispozitat e Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.
Kontributi i qytetarëve dhe i të gjitha palëve të interesuara është i rëndësishëm për të siguruar që Rregullorja të jetë transparente, e drejtë dhe e zbatueshme në praktikë, duke u mundësuar përfituesve potencialë të njihen me kushtet dhe kriteret për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Junikut.
**Data: 30.10.2026**
**Ora: 14:00**
**Vendi: Salla e Kuvendit Komunal**

Për dërgimin e komenteve, propozimeve dhe sugjerimeve ne forme elektronike mund ta bëni në e-mail: besart.tofaj@rks-gov.net deri më 05.11.2026.

*Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe materialet tjera janë të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Junikut.*

**Kryesues: Besart Tofaj**

Ju mirëpresim!